

FTESË PËR OFERT

Emri: Milieukontakt Shqipëri
Adresa: Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion,
Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri
E-mail: office@milieukontakt.org
Afati i dorëzimit të ofertës: 8/6/2026

Milieukontakt Shqipëri po zbaton projektin **“Mjedisi në sytë e të rinjve (N’SJ)”**, mbështetur nga **Bashkia e Tiranës**. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, organizata kërkon të realizojë procedurën e thjeshtë të prokurimit për:

“Shërbim ekspertize – Anëtar Jurie për vlerësimin e filmave me mesazhe mjedisore”

Kushtet për pjesëmarrje

Të gjithë subjektet, personat fizikë apo ekspertët e interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre, sipas kushteve të përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose nëpërmjet postës në adresën:

Rr. “Xhorxhi Martini”, Pall. Teuta Konstruksion, Shk. 3, Ap. 8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.

Ofertat duhet të përmbajnë propozimin financiar, CV-në/profilin profesional të ekspertit, eksperiencën përkatëse në fushën e mjedisit apo fusha të ngjashme, si dhe disponibilitetin për realizimin e shërbimit.

Përshkrimi i shërbimit

Në kuadër të projektit Mjedisi në sytë e të rinjve (N’SJ), Milieukontakt Shqipëri do të organizojë kinemanë verore për prezantimin e videove të realizuara nga të rinjtë. Për këtë qëllim, kërkohet angazhimi i një eksperti/anëtari jurie, i cili do të kontribuojë në procesin e vlerësimit të filmave, duke u fokusuar në cilësinë e mesazhit mjedisor, qartësinë e komunikimit, rëndësinë e temës së trajtuar dhe ndikimin e mundshëm te publiku.

Anëtari i jurisë duhet të ketë formim dhe eksperiencë në fushën e mjedisit.

Specifikimet e shërbimit

Eksperti/anëtari i jurisë do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të shqyrtojë filmat e paraqitur në kuadër të projektit;
- Të vlerësojë përmbajtjen dhe mesazhin mjedisor të secilit film;
- Të marrë në konsideratë lidhjen e filmit me problematikat aktuale mjedisore;
- Të vlerësojë qartësinë, kreativitetin dhe ndikimin e mesazhit tek të rinjtë dhe komuniteti;
- Të kontribuojë në përzgjedhjen e filmave fitues, në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të jurisë;
- Të ruajë paanshmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin gjatë gjithë procesit të vlerësimit.

Profili i kërkuar i ekspertit/anëtarit të jurisë

Eksperti/anëtari i jurisë duhet të plotësojë këto kritere:

- Të ketë arsimim ose eksperiencë profesionale në fushën e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- Të ketë eksperiencë në projekte, aktivitete, trajnime, fushata apo nisma me fokus mjedisor;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi, argumentimi dhe vlerësimi objektiv;
- Përbën avantazh eksperiencia e mëparshme si anëtar jurie, trajner, ekspert, mentor apo vlerësues në aktivitete edukative, mjedisore, artistike ose rinore.

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Ofertën financiare për shërbimin;
- CV-në ose profilin profesional;
- NIPT, në rast se aplikon si subjekt/person fizik i regjistruar.

Ofertuesi duhet të garantojë se:

- Do të kryejë vlerësimin në mënyrë të paanshme dhe profesionale;
- Do të respektojë afatet e përcaktuara nga organizata;

Kushte të përgjithshme

Ofertuesi duhet:

- Të jetë person fizik, ekspert i pavarur ose subjekt i regjistruar sipas legjisllacionit në fuqi;
- Të ketë eksperiencë të dokumentuar në fushën përkatëse;

Pagesa për shërbimin do të kryhet:

- Me transfertë bankare pas përfundimit të shërbimit dhe dorëzimit të dokumentacionit të vlerësimit. Nëse është person fizik/juridik, pagesa bëhet kundrejt faturës fiskale përkatëse

dhe nëse është individ/ekspert i pavarur, do t'i mbahet Tatimi mbi të ardhurat në burim,(15%) mbi vlerën e shërbimit.

Oferta financiare

Nr	Shërbimi	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi Lekë	Totali/lekë
1	Pjesmarrje në Juri për vlerësimin e filmave me mesazhe mjedisore (në përputhje me specifikimet teknike më sipër)	ditë	1		
	Total				

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më **8 Qershor 2026**, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose nëpërmjet postës në Adresën Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e dorëzuara dorazi nuk do të merren në konsideratë.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të kontaktit. Krahas ofertës financiare të plotësuar sipas tabelës në ftesë (në Lekë), duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- Ofertën financiare për shërbimin;
- CV-në ose profilin profesional;
- NIPT, në rast se aplikon si subjekt/person fizik i regjistruar ose ID karte si individ.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.

AUTORITETIT KONTRAKTOR
Milieukontakt Shqipëri